GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ
i Gjykatës Themelore të Prizrenit

Janar – Prill 2017

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" *
Nr. 7, Prill 2017
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.gjyqesori-rks.org

PËRMBAJTJE

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

STORIE E SUKSESIT
Tridhjet e tetë praktikantë përfunduan praktikën në Gjykatën Themelore të Prizrenit
Aktgjykimet e plotfuqishme

LAJME

GJYKATA NË NUMRA
Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA
Konferenca vjetore për media e Gjykatës Themelore të Prizrenit

INTERVISTË E SHKURTË
Sabahete Kurteshi - Gjyqtarja Mbikëqyrëse, Gjykata Themelore në Dragash

SI TI QASEMI GJYKATËS?
Si caktohen dhe ndahen lëndët?

A e dini se...?!

Kontaktoni Gjykatën Themelore të Prizrenit

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Të nderuar lexues,

Drejtësia nuk është qëllim në vetvete. Ajo jepet për njerëzit dhe duhet të perceptohet prej tyre si e tillë. Njerëzit duhet ta ndjejnë thellë që drejtësia është e pavarur, e paanshme, e ndershme, e barabartë për të gjithë dhe e përgjegjshme. Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.

Gjykata Themelore e Prizrenit synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.gjyqesori-rks.org ku publiku ka qasje edhe në publikimin e aktgjykimeve të plotfuqishme me të cilat publikime gjykata e Prizrenit prinë prej gjykatave tjera për nga numri i publikimeve të tyre. Sa i përket publikimit te aktgjykimeve deri me datën 27 shkurt 2017 gjithsej kanë qenë 730 aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë, andaj për këtë sukses falënderoj stafin përgjegjës për kontributin e tyre në përgatitjen e aktgjykimeve për publikim në web faqen e gjykatës.

Përpjekje për avancimin e frymës së bashkëpunimit midis qytetarëve dhe gjykatës është edhe vazhdimi i publikimit të buletinit nr. 7 që ka bërë një hap pozitiv sa i përket informimit të qytetarëve me sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe punën e gjykatës në veçanti. Ky publikim periodik do të ofroj informacione për punën e gjykatës statistikat e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen e mediave dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Përveç suksesit që ka kjo gjykatë ka edhe sfidat me të cilat po ballafaqohet ç'do ditë. Njëra ndër sfidat kryesore kemi mungesën e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional stafit administrativ, mungesën e përkthyesve e të cilat paraqesin një sfidë sa i përket punës së kësaj gjykate.

Sfidë tjetër kemi edhe mungesën e hapësirës së gjykatës, ku kemi bërë një kërkesë me shkrim në KGJK për dertimin e një ndërtese të re të gjykatës përmes së cilës do të rritet edhe efikasiteti i punës së kësaj gjykate.

Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykatë e hapur, e cila do të vazhdoi të investojë në forcimin e standardeve profesionale dhe të transparencës.

Ymer Hoxha
Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren

STORIE SUKSESIT

Grafika më poshtë tregon publikimet e aktgjykimeve të plotfuqishme në web faqen e Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës së tre mujorit të fundit të vitit 2016 dhe tremujorit të parë të vitit 2017.



Tridhjetetetë praktikantë përfunduan praktikën në Gjykatën Themelore të Prizrenit

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit kanë përfunduar praktikën njëvjeçare 38 praktikantë të cilët kanë kryer punë vullnetare në këtë Gjykatë. Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit, Z. Ymer Hoxha në takimin përmbyllës me praktikantët, i ka falënderuar për vullnetin dhe punën e palodhshme që kanë treguar gjatë një viti."Unë besoj se njohuritë dhe eksperiencat e fituara gjatë një viti do t'iu ndihmojnë në ndërtimin e një karriere të suksesshme në fushën e drejtësisë". Të gjithë kandidatët u pajisën me certifikata nga Gjykata Themelore e Prizrenit.

LAJME

Nxënësit e shkollës "Ymer Prizreni" vizituan Gjykatën Themelore

Më 7 Shkurt 2017, Gjykatën e vizituan nxënësit e drejtimit juridik të shkollës së mesme "Ymer Prizreni" në Prizren. Vizita kishte karakter të praktikës për nxënësit e drejtimit juridik nën përcjelljen e mësimdhënëses së kësaj shkolle. Nxënësit u vendosën në njërën nga sallat e gjykimit ku u pritën nga zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj e cila prezantojë strukturën e gjykatës, punën që bënë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit me qytetarët dhe mjetet e zhvilluar, për krijimin e një lidhje më të mirë me qytetarët ku edhe vazhduan me diskutimet e hapura. Në pjesën e dytë të takimit, nxënësit patën mundësi të njihen me objektin e gjykatës, me punën që bënë secila zyre me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës. Gjykata do të vazhdojëi traditën e bashkëpunimit me qytetarët,me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

Vizita e grupit të dytë dhe tretë e nxënësve të shkollës së mesme ”Ymer Prizreni” Në fund të muajit shkurt

Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizitoi grupi i dytë dhe tretë i nxënësve të shkollës së mesme,”Ymer Prizreni” në Prizren, drejtimi juridik. Gjykata synon të angazhohet në komunikim të shtuar me shkollat e mesme te Prizrenit dhe ky angazhim përfshin informimin e të rinjve për punën e gjykatës dhe ofrimin e mundësive për të vizituar gjykatën (dhe përcjellur seancat e hapura gjyqësore). Gjykata do të vazhdojë traditën e bashkëpunimit me qytetarët dhe me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

Ministrja e Drejtësisë e vizitoi Gjykatën Themelore të Prizrenit

Ministrja e Drejtësisë Znj. Dhurata Hoxha se bashku me bashkëpunëtorët e saj ka vizituar Gjykatën Themelore të Prizrenit me ç'rast u prit nga Kryetari i kësaj Gjykate Z. Ymer Hoxha. Qëllimi i këtij takimi ka qenë thellimi i bashkëpunimit dhe avancimit të proceseve brenda përgjegjësive të ndërsjella si dhe për tu njohur me rezultatet e punës dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet kjo Gjykatë. Kryetari i Gjykatës gjatë këtij takimi ka njoftuar ministren Hoxha për rezultatet, aktivitetet dhe sfidat e kësaj gjykate. Njëra nga sfidat e kësaj gjykate është edhe numri jo i mjaftueshëm i gjyqtarëve i bashkëpunëtorëve profesionalë dhe stafit administrativ, si dhe hapësirat e pamjaftueshme të gjykatës të cilat po e vështirësojnë dukshëm punën e Gjykatës. Përveç sfidave dhe rezultateve te punës si çështje qe diskutuan ne këtë takim ishte edhe procesi i reformës legjislative. Nga ana e Gjykatës u ofruan disa propozime për amendamentim të Kodeve Penale dhe disa ligjeve të natyrës civile. Gjithashtu u diskutua dhe u gjet konsensus për dërgimin e gjyqtarëve profesionistë të kësaj gjykate, të marrin pjesë në kuadër të grupeve punuese të cilët do të kontribuojnë në amandamentimin e ligjeve.

Ne anën tjetër ministrja e drejtësisë Znj. Dhurata Hoxha, tha se vizitën e saj po e realizon me qëllim të njoftohet për së afërmi me kushtet në të cilat punon kjo gjykatë dhe gjithashtu të njoftojë Kryetarin për mbështetjen e fuqishme në punën qe po e bëjnë. “Realizimi i kësaj vizite është bërë me qëllim që ta informojë Kryetarin se me procesin e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit presim kontributin e tyre që me të vërtetë të bëjmë reforma të thella, ta fuqizojmë ligjin por gjithashtu të bartim edhe mesazh tek qytetarët e vendit se të gjithë do të jenë të barabartë para ligjit” shtoi ajo. Sa i përket reformave për ndryshim të ligjit, Hoxha theksoi se rishikimi funksional i sundimit të ligjit është reformë gjithëpërfshirëse dhe është duke u bërë për herë të parë në Republikën e Kosovës. Gjatë këtij takimi u zhvillua debat shumë produktiv rreth fuqizimit të sundimit të ligjit, ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Studentët e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti” vizitojnë gjykatën

Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren. Vizita kishte për qëllim të nxisë komunikimin më të besueshëm ndërmjet studentëve dhe Gjykatës Themelore në Prizren dhe tu mundësoj atyre të njihen për së afërmi me gjykatën dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme. Studentët u vendosën në njërën nga sallat e gjykimit ku u pritën nga kryetari i Gjykatës z.Ymer Hoxha dhe zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj. Prezantimet fillestare u pasuan me diskutim me studentët dhe përfaqësuesit e gjykatës. Ndër të tjera u diskutua për të rejat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takime direkte me kryetarin e Gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun. Në pjesën e dytë të vizitës, studentët vizituan objektin e gjykatës dhe u njohën me shërbimet që i ofron ajo për qytetarët e Prizrenit, me sallat e seancave gjyqësore dhe panë se ku dhe si operojnë departamentet brenda gjykatës.

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela e mëposhtme paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit për tre mujorin e parë të vitit 2017, si ato të trashëguara në fillim të vitit 2017, të ardhura, lëndët ne proces, lëndët që janë përfunduar në këtë tre mujor dhe ato të mbetura në fund të gjashtë mujorit të dytë të vitit 2016. Statistikat e punës për tre mujorin e parë te vitit 2017 janë dëshmia e radhës numerike e përkushtimit maksimal të gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Gjykata Themelore në Prizren	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim te tremujorit të parë 2017	Lëndët e ardhura gjatë tremujorit të mujorit të parë 2017	Gjithsej lëndët në punë gjatë tremujorit të parë 2017	Lëndët e kryera gjatë tremujorit të parë 2017	Lëndët e mbetura në fund tremujorit të parë 2017
Dep. për Krime të Rënda	Penale	257	36	293	49	244
	Paraprake	214	31	245	42	203
Dep. i Përgjithshëm	Penale	3832	719	4551	643	3908
	Paraprake	669	165	834	33	801
	Civile	1204	395	1599	405	1194
	E.Civile	9257	550	9807	934	8873
	E.P. Me Burg	103	29	132	68	64
	E.P. Me Gjobë	999	167	1166	260	906
	Të Ndryshme	0	3402	3402	3402	0
	Trashëgimore	35	16	51	37	14
	Jashtkontestimore	383	224	607	157	450
Dep. për të Mitur	Penale Para Kolegjit	218	39	257	39	218
	Përgatitore	89	44	133	47	86
Divizioni i Kundërvajtjes	Kundërvajtje	12137	3115	15252	6227	9025
TOTALI		29397	8932	38329	12343	25986

Konferenca vjetore për media e Gjykatës Themelore të Prizrenit

Gjykata Themelore e Prizrenit në janar të këtij viti mbajti konferencën e parë për media ku u prezentua raporti i punës vjetore për vitin 2016 të kësaj gjykate. Kryetari Ymer Hoxha gjatë prezentimit të raportit të punës për gjykatën ka njoftuar për zvoglimin e numrit të lëndëve të bartura, të kryera për vitin 2016. Edhe pse gjykatat vazhdojnë të veprojnë me kapacitete të kufizuara, efikasiteti i gjyqtarëve gjatë vitit 2016 në përqindje ka qenë - Gjykata Themelore e Prizrenit me 98.02 %, Gjykata Themelore në Prizren dega Suharekë me 88,32%, Gjykata Themelore në Prizren dega në Dragash me 101.30% që është dëshmi e përkushtimit të stafit të Gjykatës Themelore në Prizren së bashku me degët.

Vlenë të cekët se statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit i rëndon më tepër Divizioni i Kundervajtjes, ndërsa lëndët me peshë si lëndët që i përkasin Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit të Përgjithshëm Penal dhe Civil, ka arritur që numri i këtyre lëndëve të zvoglohet dukshëm. Sipas Z.Hoxha, gjykatat vazhdojnë të kenë nevojë edhe për gjyqtarë shtesë, për bashkpunëtorë profesional, për përkthyes, për rritjen e numrit të stafit administrativë, në atë mënyrë që të shtohet niveli i efikasitetit në këtë gjykatë. Gjatë periudhës raportuese gjykata ka bashkpunuar ngushtë me mediat, OSBE-në, policinë prokurorinë me organizatat joqeveritare e në veçanti me OJQ EC Ma Ndryshe.

Sabahete Kurteshi - Gjyqtarja Mbikëqyrëse, Gjykata Themelore në Dragash

1. Cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet dega e gjykatës në Dragash?

Me heqjen e mbikëqyrjes ndërkombëtare ndaj gjykatave fillon faza e riorganizimit të gjyqësorit në Kosovë ashtu që gjykatat Komunale me 01.01.2013 pësojnë reforma duke u adoptuar kushteve të Republikës së Kosovës dhe në bazë të standardeve të shteteve të Bashkimit Europian duke marr për bazë dhe praktikat e tyre të mira. Nga janari i vitit 2013 në gjyqësor po dhe në degën e kësaj gjykate është filluar me strukturën e re organizative e ketë si rezultat i hyrjes në fuqi të " Ligjit Nr.03/L-199 mbi Gjykatat " dhe "Ligji Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës", ashtu që ky rekonstruktim i ri për mua si Gjyqtare Mbikëqyrëse ka qenë një ndër sfidat dhe të arriturat në Gjykatë.

Themi sfidë sepse kjo gjykatë që në fillim u ballafaqua me mungesën e gjyqtarëve, stafit profesional (pa bashkëpunëtorë profesional, zyrtar ligjor, zyrtar financiar) sepse stafi i vjetër është 90% me arsimim të mesëm, e që kjo ndikoj në mungesën e arritjes së qëllimeve që unë në fillim të vitit ja kam parashtruar vetës si udhëheqëse e kësaj dege. Sfiduese ishte përmbushja e detyrave si në reduktimin e lëndëve, procedimin e rasteve të reja, përdorimin e teknikës kompjuterike, mungesa e ofrimit të ndihmës për gjyqtar nga ana e bashkëpunëtorit profesional, mungesa e njohurive te stafit përgjegjës në zbatimin e drejtë të rregulloreve dhe udhëzimeve të KGJK-ës si në çështjet civile po dhe ato penale.

Andaj mungesa e gjyqtarëve dhe atë një gjyqtarë, një bashkëpunëtor profesional, zyrtar për financa, zyrtar ligjor ka ndikuar drejtpërdrejtë në punën tonë si në efikasitet, në kualitete të punës dhe në paraqitjen e mos kënaqësisë së KGK-ja nuk ka pas kujdes në emërimin e gjyqtarëve sepse në disa gjykata ka mjaftë gjyqtar e ndërsa në të tjerat jo. Kjo sipas meje ka ndikuar dhe në transparencë me publikun sepse unë si gjyqtare nuk e kam pas atë privilegj që të bëjë transparente punën tonë në atë nivel që qytetari të njoftohet se punohet në këtë gjykatë e kjo për shkak se unë njëkohësisht kam qenë e ngarkuar dhe me raste të gjitha natyrave që i takojnë departamentit të përgjithshëm përveç obligimeve në organizimin e punës dhe drejtimin e kësaj gjykate në udhëheqje. Ketë e them se dhe ka munguar interesimi i Gjykatës Themelore që ndonjëherë të paraqes dhe të arriturat tona në web-faqen e gjykatës. Përkundër këtyre sfidave qe jemi ballafaquar në vitin 2013 ne ja kemi arritur me punë dhe me përkrahjen e stafit që ti kryejmë detyrat dhe të ruajmë autoritetin dhe dinjitetin e gjykatës.

2. Si komunikoni me qytetarët rreth punës së Gjykatës dhe sa janë të kënaqur qytetarët e Komunës së Dragashit me punën tuaj?
Kjo gjykatë me qytetarët komunikon drejtpërdrejtë por dhe në ditën e caktuar që është çdo muaj si ditë takimi me qytetarët ku kanë të drejtat e tyre qe të paraqesin vërejtje në punën e gjykatës të kërkojnë arsyet e mos zgjidhjes së çështjeve dhe caktimit të tyre, trajtimin me kujdes. Komunikimi me qytetarët në rastet e çështjeve të paraqitura në gjykatë bëhet përmes dorëzimit të thirrjeve dhe përmes monitorit ku qytetari në fakt personi i interesuar çdo ditë dhe në çdo kohë ka mundësinë e shikimit të çështjeve të caktuara në gjykatë si orën, gjyqtarin e çështjes etj. Qytetari ka mundësinë që këto informacione t'i marrë edhe online përmes web faqes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kjo gjykatë ka edhe këndin ku në të vendosen informata apo doracakë të sjella nga organizatat ndërkombëtare e vendore, Buletini i gjykatës dhe të tjera.

3. Sa lëndë procedohen brenda një viti në degën tuaj dhe si qëndron gjykata juaj me procedimin e lëndëve të vjetra?
Gjatë vitit në këtë gjykatë numri i lëndëve është 4.176 raste ku prej tyre janë të zgjidhur 3.222 lëndë ndërsa në punë janë 954 lëndë. Andaj përafërsisht presim dhe në ketë vit. Sa i përket lëndëve të vjetra kjo gjykatë në ketë vitë ka filluar me procedimin e lëndëve -lëndë të caktuara të vitit 2016 dhe vitit 2017. Lëndët të viteve tjera që kanë mbetur në punë janë lëndë ku të pandehurit apo palët tjera nuk janë gjendur në Kosovë ose shkaku i adresave të panjohura.

4. Çfarë bashkëpunimi keni me organizatat e shoqërisë civile në Dragash?
Bashkëpunimi me organizatat Jo qeveritare për monitorimin e punës së gjykatës dhe si vëzhgues dhe matës të integritetit të gjyqtarëve dhe vetë Gjykatës. Kemi nënshkruar me pëlqim të kryetarit të Gjykatës se bashku me të dhe memorandume të bashkëpunimit me këto organizata qe kanë bërë monitorimin e kësaj gjykate, bashkëpunimi i mirë me Mekanizmin Komunal kundër dhunës në familje, me OJQ tjera si OJQ " CEDD" me seli në Prishtinë (monitorimi i lëndëve te Zgjedhjeve – vendosja dhe aktgjykimet, me OJQ"Iniciativa e Gruas"me seli në Dragash, Forumin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Nuk mungon dhe Bashkëpunimi dhe me Institucionet relevante Shtetërore dhe është i mirë si me: Policinë e Kosovës dhe Policinë e Vijës së Gjelbër-në ruajtjen e kufijve.

5. A ka interesim nga qytetarët dhe studentët për pjesëmarrje në seance gjyqësore të hapura për publikun ?
Gjithsesi interesimi është në nivel. Përveç praktikantëve të gjykatës pjesëmarrja e publikut nuk mungon, nuk mungon pjesëmarrja e nxënësve të Shkollës së mesme të dy komuniteteve, pjesëmarrja e nxënësve të shkollave fillore përmes OJQ-së Iniciativa e Gruas.

6. A mund te na ilustroni praktikisht zbatimin e parimit te barazisë para ligjit ne gjykatën tuaj?
Patjetër, duke u bazuar në ligjet në fuqi e posaçërisht në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut jemi të obliguar si gjykatë qe palëve në procedurë e posaçërisht palës së pandehur t'i japim të drejtat të barabarta për të realizuar mbrojtjen e tij në gjykatë. Kjo shihet në të drejtën e palëve në mbledhjen e provave qoftë në prokurori apo në gjykatë, dorëzimi i provave të pandehurit, gjatë pranimit të fajësisë, kanë të drejtat të barabarta këtu i dëmtuari dhe i pandehuri në fjalën hyrëse për shembull thirrja e dëshmitarëve, paraqitja e provave dhe fjala përfundimtare, çdo palë qoftë në çështje penale apo civile dhe çështje tjera janë të barabartë para ligjit dhe gjykata ka kujdes në realizimin e këtij parimi në gjykatore duke mos i mohuar asnjëherë të drejtat themelore të palëve në procedurë që parashihen me kode penale dhe ligjet civile në fuqi. Duhet të ceki se posaçërisht kjo gjykatë vëmendje të posaçme i kushton edhe barazisë së shfrytëzimit të gjuhës amtare të komuniteteve ku çdo gjykim çdo shkresë është e përkthyer këtu tek ne në gjuhën Serbe-Boshnjake.

Andaj gjatë këtyre viteve në vazhdim gjykatën që do të menaxhoj të jenë transparente, e pavarur, efikase, profesionale dhe e mbështetur në ligje në vendimmarrje, integritet për gjyqtar dhe staf mbështetës, përmirësim të kushteve të punës, avancim, llogaridhënien për staf, ripërtëritja e kërkesave për emërim të gjyqtarit, bashkëpunëtorit profesional, zyrtari ligjor apo financiar, rritja e buxhetit, me qëllim që të arrihet synimi për një Gjykatë të sigurt dhe me rezultate të mira. Të gjitha këto do të arrihen vetëm me punë, përgjegjësi, bashkëpunim me Gjykatën Themelore në Prizren dhe institucionet tjera të Drejtësisë si dhe bashkëpunimi me Organizatat ndërkombëtare.

SI TI QASEMI GJYKATËS?
Si caktohen dhe ndahen lëndët?
Shpërndarja e lëndëve tek gjuqtarët bëhet me short. Të gjitha lëndët e pranuara ndahen në grumbuj sipas numrit të gjyqtarëve dhe llojit të lëmisë juridike gjyqësore. Mbi çdo grumbull të lëndëve vihet një procesverbal në të cilin përshkruhet numri dhe lloji i lëndëve të cilat do të tërhiqen nga gjyqtari të cilit i bie shorti.

A e dini se...?!

- Të gjithë personat fizikë në kushte të njejta janë të barabartë në trashëgimi.
(LIGJI Nr.2004/26 Për trashëgimi, Neni 3,Paragrafi 1).

- Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllëzërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.
(LIGJI Nr.2004/26 Për trashëgimi Neni 11,Paragrafi 1).

SI TI QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

Shpërndarja e lëndëve tek gjuqtarët bëhet me short. Të gjitha lëndët e pranuara ndahen në grumbuj sipas numrit të gjyqtarëve dhe llojit të lëmisë juridike gjyqësore. Mbi çdo grumbull të lëndëve vihet një procesverbal në të cilin përshkruhet numri dhe lloji i lëndëve të cilat do të tërhiqen nga gjyqtari të cilit i bie shorti.

A e dini se...?!

- Të gjithë personat fizikë në kushte të njejta janë të barabartë në trashëgimi.

(LIGJI Nr.2004/26 Për trashëgimi, Neni 3,Paragrafi 1).

- Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllëzërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.

(LIGJI Nr.2004/26 Për trashëgimi Neni 11,Paragrafi 1).

Kontaktoni Gjykatën Themelore të Prizrenit

Zyra e Administratës
Tel: +381 (0) 29/244 122

Adresa
Gjykata Themelore e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu ", p.n.
Prizren, Kosovë
Vizito :
www.gjyqesori-rks.org

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – PRIZREN TEMEL MAHKEMESI
BASIC COURT OF PRIZREN

Ky publikim është rezultat i Gjykatës Themelore të Prizrenit